



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 50 regjistër (JR)
Datë 14.10.2019

Nr. 18 i vendimit
Datë 12.07.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ardian Hajdari	Relator
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 12.07.2021, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 190, datë 26.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ramiz Lala.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenet 59, pika 4, dhe 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 26.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit Ramiz Lala, me ndryshimin: “Transferimin e çështjes administrative me nr. {***} vendimi, datë 14.05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, pranë organit kompetent për inspektim,

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, dëgjoji subjektin e rivlerësimit Ramiz Lala, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 26.07.2019, të Komisionit, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni, ka mbajtur detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër (në vijim “GjASHPGj”), dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Më parë, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të neneve 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet ndihmëse, përkatësisht: a) deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit/*vetting* (në vijim “deklarata *vetting*”) pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) formularin për vetëvlerësimin profesional pranë ish-Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e kriterit pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
- (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

2.2. DSIK-ja, pasi kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, në zbatim të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, bazuar nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi raportin² e saj pranë Komisionit, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

2.3. KLD-ja, pasi kreu vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, bazuar nënenin 43 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi një raport³ të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 28.02.2018.

² Raporti i DSIK-së nr. {***} prot., datë 27.10.2019.

³ Raporti i KLD-së nr. {***} prot., datë 14.12.2018.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse, kreu hetimin administrativ, administroi provat përkatëse dhe dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, mori vendimin nr. 190, datë 26.07.2019, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ramiz Lala, bazuar në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit: arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë; arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës; dhe arrin nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Me vendimin nr. 190, datë 26.07.2019, Komisioni vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ramiz Lala, me funksion gjyqtar/drejtues në GjAShPGj.
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

5.1. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioni ka konkluduar se: *64.1.[...] Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve respektive. 64.2 Në lidhje me problematikat e analizës financiare, trupi gjykues çmon se këto pasaktësi dhe këto mangësi të burimeve financiare - për një total të akumuluar në shumën prej 160,961 lekësh (me bilancin më negativ në analizën e muajit janar 2017, që arrin në minus 72,675 lekë) - nuk janë të mjaftueshme që të pasjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. 64.3 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, nuk konstatohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. 64.4 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe as besimin e publikut të drejtësisë. 64.5 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

5.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka konkluduar se: *66.1 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. 66.2 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

5.3. Në lidhje me kriterin vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se: 76.1 Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar problematikat mbi gjetjet e konstatuara, ku nga vlerësimi tërësor i tyre, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk vërehen rrethana që mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional. 76.2 Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjyqësor vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit. 76.3 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional. 76.4 Për sa më sipër, trupi gjyqësor arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gurmës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit

6. Kundër vendimit nr. 190, datë 26.07.2019, të Komisionit, më datë 03.10.2019, ushtroiankim⁴Komisioneri Publik FlorianBallhysa.
7. Komisioneri Publik, fillimisht nëpërmjet ankimit, pasi është njohur me vendimin e arsyetuar të Komisionit, në lidhje me kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe profesionalizmit, në mënyrë të përmbledhur, respektivisht ka kërkuar nga Kolegji:
 - 7.1 a) Të rivlerësojë zërat e analizës financiare për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, ku Komisioni ka reduktuar zërin e pagesës së shpenzimeve dhe transportit në Përmet dhe Gjirokastër⁵, pasi në këto vite subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me balancë negative dhe, në varësi të rezultatit:
 - b) Të konkludojë mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme të ardhurat e deklaruara dhe shpenzimet e kryera.
 - 7.2 Në lidhje me një informacion të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Komisioneri ka kërkuar që Kolegji të verifikojë ligjshmërinë e vendimmarrjeve ku Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka qenë palë e paditur, për sa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbi gradat policore, sipas vendimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, përkatësisht për paditësin A. Gj.dhe për paditësin S. R..
8. Në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik, në rrethanat e rezultuara pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes, kur mangësitë/problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale dhe të kriterit të pasurisë, veçmas nuk i rezultuan të mjaftueshme për t'u gjendur në kushtet e zbatimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 59, pika 4,

⁴Vendimi i arsyetuar i Komisionit i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 22.09.2019, Komisioneri Publik në datën 18.09.2019 dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 17.09.2019, dhe ndaj tij është ushtroar ankim nga Komisioneri Publik në datën 03.10.2019, i cili u pranua nga Komisioni me vendimin nr. 190/1, datë 04.10.2019.

⁵Në referim të f. 24, paragrafi 61.3 i vendimit të Komisionit.

dhe nenit 66, pika 1 e shkronjës“a” të ligjit nr. 84/2016, përfundimisht kërkoi nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.190, datë 26.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Ramiz Lala, me ndryshimin:
- Transferimin e çështjes administrative me nr. {***} vendimi, datë 14.05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, pranë organit kompetent për inspektim, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II.1. Shkaqe ankimi që lidhen me kontrollin e kriterit të pasurisë

9. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik në ankimin e paraqitur dhe pretendimet e parashtruara gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, pretendoi se Komisioni në analizën financiare përfundimtare për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, kishte reduktuar zërin e pagesës së shpenzimeve dhe transportit, Përmet dhe Gjirokastrë, dhe zërin e pagesës së shpenzimeve të qirasë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk kishte ngritur pretendime në këtë drejtim.

9.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mbetej e paqartë pse në analizën financiare të kryer nga Komisioni ishin zbritur shpenzimet për zërat ushqim, transport dhe fjetje, duke marrë në konsideratë vlerat monetare të dietave të kredituara në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar gjithashtu se: “Nga aktet në dosje, konstatohet se vlerat e shpenzimeve të zbritura nga Komisioni, përveç se janë në tejkallim të pretendimeve të vetë subjektit, janë në tejkallim edhe të vlerave të dietave të kredituara në llogaritë bankare të tij⁶”.

9.2 Në vijim të pretendimeve të mësipërme, Komisioneri Publik kërkoi Kolegjit të rivlerësonte zërat e analizës financiare për periudhën gjatë viteve 2011, 2014, 2015 dhe 2016, dhe të konkludonte mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme të ardhurat e deklaruara dhe shpenzimet e kryera.

10. Komisioneri Publik, në seancën gjyqësore të datës 22.06.2021, parashtroi se analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të datës 02.06.2021 të trupit gjykues, përmbushte shkaqet e ankimit të paraqitur prej tij, dhe në pretendimet përfundimtare të datës 07.07.2021, në zbatim të legjislacionit të aplikueshëm, si dhe jurisprudencës së Kolegjit në vlerësimin e kontrollit të kriterit të pasurisë të subjekteve të rivlerësimit, parashtroi se mungesa e burimeve të ligjshme, e konstatuar për vitet objekt analize, në shumën totale prej (-) 939.061 lekësh, nuk gjendej e mjaftueshme për t’u kualifikuar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

II.2. Shkaqe ankimi që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale

11. Pas informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim “DPPSh”), Komisioneri Publik, në ankimin e paraqitur dhe pretendimeve të paraqitura gjatë gjykimit, kërkoi nga Kolegji që të verifikonte ligjshmërinë e vendimmarrjeve mbi gradat policore sipas vendimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të GjA ShPGJ-së, përkatësisht:

⁶Referuar nënparagrafit 32.2 të ankimit, datë 03.10.2019, të Komisionerit Publik.

- a) për njohjen e gradës policore “Drejtues” palës paditëse A. Gj.; dhe
- b) njohjen e gradës pliciore “Drejtues i parë”, palës paditëse S.R.

12. Për çështjen që i përkishte paditësit A. Gj.⁷, me detyrë shef i Komisariatit të Policisë Gjirokastër, Komisioneri Publik pretendoi se dhënia e gradës “Drejtues” duke u mbështetur në vjetërsinë në punë, është në kundërshtim me nenet 50 - 62 të ligjit nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit” (në vijim “ligji nr. 108/2014”), i cili rregullon në mënyrë të detajuar sistemin e gradave, procedurat administrative që ndiqen për fitimin e gradave, arsimimin, konkurrimin dhe ankimimin administrativ, para se çështja t’i nënshtrohej juridiksionit gjyqësor⁸.

12.1. Sipas Komisionerit Publik, nuk konstatohej që pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim “DPPSh”), në zbatim të *neneve* 6, pika 3, 40, 50, 53 të ligjit nr. 108/2014, dhe nenit 161 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.09.2015, “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit” (në vijim “VKM nr. 750/2015”), të kishte organizuar një proces konkurrimi për dhënien e gradave, në mënyrë që të legjitimohej shqyrtimi i çështjes nga juridiksioni gjyqësor, çka për Komisionerin, referuar nenit 72, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, përbën mungesë të argumentimit të nevojshëm ligjor, referuar cilësisë së analizës, të njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor.

13. Për çështjen që i përkiste paditësit S. R.⁹, me gradë “Kryekomisar”, Komisioneri Publik pretendoi se, përveç se në kundërshtim me ligjin nr. 108/2014, i ishte dhënë paditësit grada “Drejtues i parë”, gjithashtu ishte urdhëruar edhe pagesa e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare nga data 01.07.2008¹⁰, duke pasur edhe një vendim tjetër të formës së prerë për këtë çështje.

13.1. Sipas Komisionerit Publik, përveç pikës së parë të pjesës urdhëruese të vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjASHPGj-së¹¹, kërkimet e tjera të çështjes ishin *gjë e gjykuar*, çka për Komisionerin Publik, referuar nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 906/2016, përbën mangësi në drejtim të njohurive ligjore, të garantimit të parimeve të pranuarra të së drejtës, si dhe të aftësisë për të analizuar jurisprudencën.

14. Komisioneri Publik, në pretendimet përfundimtare, datë 07.07.2021, lidhur me vendimet mbi të cilat subjekti i rivlerësimit kishte disponuar në cilësinë e gjyqtarit të GjASHPGj-së, vlerësoi përkatësisht se:

- a) vendimi nr. {***}, datë 28.03.2017, që i përkiste palës paditëse A. Gj., dukej se kishte elemente për t’u marrë në konsideratë në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, në drejtim të argumentimit të nevojshëm ligjor, referuar cilësisë së analizës, njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, të lidhura me dhënien e gradës policore gjyqësisht, si rezultat i plotësimit të kriterit të vjetërsisë në gradë;

⁷Vendimi nr. {***}, datë 28.03.2017, i GjASHPGj-së.

⁸Përkatësisht: a) nxjerrja e urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm për fillimin e procedurave konkurruese për një numër të kufizuar të vendeve të lira për gradën Drejtues për vitin respektiv, sipas nenit 54 të ligjit nr. 108/2014; b) verifikimi i kandidatëve konkurrues, sipas nenit 56 të ligjit nr. 108/2014; c) kryerja e testimit, sipas nenit 57 të ligjit nr. 108/2014; dhe ç) ndjekja eventuale e procedurave të ankimit administrativ, sipas nenit 60 të ligjit nr. 108/2014, vetëm pas ezaurimit të të cilave, sipas Komisionerit, do t’i lindte e drejta palës paditëse për t’iu drejtuar juridiksionit gjyqësor.

⁹Vendimin nr. {***}, datë 14.05.2019, i GjASHPGj-së.

¹⁰Përkatësisht, pagesën dhe përfitimet e tjera financiare nga data 01.07.2008, në masën prej 15.072.204 lekësh.

¹¹Mbi shfuqizimin e urdhrat nr. {***} të DPPSh-së.

- b) vendimi nr. {***}, datë 14.05.2019, që i përkiste palës paditëse S.R., kishte elemente për t'u vlerësuar në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, interpretimit ligjor dhe aftësisë për të analizuar jurisprudencën, konkretisht mbi interpretimin e parimeve ligjore që rregullojnë institutin e sigurisë juridike, mbi kërkime gjyqësore të palës paditëse, që rezultojnë gjë e gjykuar, mbi shkaktimin e dëmit pasuror si rezultat i disponimit, ndër të tjera, përtej vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 19.04.2012¹², si dhe dhënien e gradës policore gjyqësisht për shkak të ushtrimit të funksionit përkatës, për gradën e pretenduar; dhe
- c) evidentoi se në faqen zyrtare në internet të Gjykatës së Lartë, në rubrikën "Njoftime për publikun", që i përket datës 24.06.2021¹³, ndër të tjera, ishte komunikuar se: "[...] Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 62/a të ligjit nr. 49/2012, pas ndryshimeve me ligjin nr. 49/2021, çmon të nisë procedurën e gjykimit për njësimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për njësim këtë çështje: A mund të fitohet gjyqësisht grada policore për shkak të plotësimit të kriterit të vjetërsisë në gradë dhe/ose ushtrimit të funksionit përkatës për gradën e pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së vlerësimit konkurrues nga një komision gradimi? Për sa më sipër, Kolegji vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore në datë 15.7.2021, ora 09:00[...]"

15. Në përfundim, Komisioneri Publik, në vlerësim të sa më sipër, nisur dhe nga statusi ligjor i çështjeve të trajtuara më sipër, vlerësoi se situatat e identifikuara në lidhje me kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, të vetme në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, nuk ishin të tilla që subjekti i rivlerësimit të konsiderohej i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e gjyqtarit, sipas nenit 44, germa "c" e ligjit nr. 84/2016.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

16. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

17. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda

¹²I cili kishte vendosur detyrimin e palës së paditur t'i paguante paditësit S. R., pagën që i përkiste gradës "Kryekomisar" për një vit.

¹³http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Njoftim_per_publicun_10556_1-752.php.

afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016. Përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ankimi i Komisionerit Publik ishte ngritur jashtë afatit, rezulton se vendimi i arsyetuar i Komisionit iu njoftua Institucionit të Komisionerëve Publikë në datën 18.09.2019, dhe ndaj këtij vendimi, Komisioneri Publik ka ushtruar ankim në ditën e 15 pas njoftimit, përkatësisht në datën 03.10.2019. Kolegji, në funksion të kontrollit të vendimeve të Komisionit, përfshi edhe vendimet për pranimin e ankimeve, verifikoi afatin e dorëzimit të ankimit nga Komisioneri Publik dhe u konstatua se ankimi është depozituar në Komision sipas ligjit, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 63 të paragrafit 1 të ligjit nr. 84/2016. Ky konstatim vjen në interpretim dhe zbatim tëparashikimeve të nenit 148, paragrafi 1i Kodit të Procedurës Civile, se: “Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati”, i cili bëhet për shkak dhe interpretim të referimit që neni 4, paragrafi 6 i ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 1, paragrafi 2 dhe 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”(në vijim “ligji nr. 49/2012”) bëjnë te Kodi i Procedurës Civile. Për rrjedhojë, duke përjashtuar datën 18.09.2019, afati i depozitimit të ankimit të Komisionerit Publik, i cili, sipas parashikimeve të nenit 148, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Civile, ka filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit nr. 190, datë 26.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përkatësisht më datë 19.09.2019, dhe dita e 15që është brenda afatit ligjor, rezulton të jetë pikërisht në datën e depozitimit të ankimit, data 03.10.2019.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

18. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016¹⁴, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 190, datë 26.07.2019, për subjektin e rivlerësimit Ramiz Lala, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik dhe atyre të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.

19. Trupi gjykues, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegji, pasi pranoi kërkesën e Komisionerit Publik për hetime të mëtejshme, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: (i) të kërkonte nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër, fashikullin e gjykimit të çështjes administrative për të cilën kjo gjykatë ka dhënë vendimin me nr. {***}, datë 28.03.2017, për padinë me palë paditëse A. Gj. dhe palë e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; (ii) të kërkonte nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë¹⁵, një kopje të fashikullit të gjykimit të çështjes administrative të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, përtëcilën kjo gjykatë ka dhënë vendimin me nr. {***}, datë

¹⁴Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

¹⁵Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nuk iu kërkua të përcillte në Kolegji, kopje të ankimit dhe të çdo akti procedural që lidhet me shqyrtimin e ankimit nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

14.05.2019, përpadinë me palëpaditëse S. R. dhe palë e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; (iii) t'i kërkonte Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit të bënte një analizë paraprake financiare për subjektin e rivlerësimit për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016; dhe (iv) të pranonte në cilësinë e provës të gjitha aktet e paraqitura në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit.

19.1. Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në funksion të parimeve të pavarësisë dhe autonomisë së gjykatave, nuk iu kërkuar nga trupi gjykues që të përcillte në Kolegj kopje të ankimit dhe aktet që mund t'i jenë bashkëlidhur atij, apo të çdo akti procedural lidhur me ankimin e paraqitur për shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë kundër vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me palë paditëse S. R. dhe palë të paditur DPPSh-në, dhe Kolegji, gjatë shqyrtimit të çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit, nuk mori në shqyrtim pretendimet dhe rrethanat e shqyrtimit të këtij ankimi, të cilat janë në kompetencë të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

19.2. Provat e ardhura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër dhe nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe analiza financiare Njesisë së Shërbimit Ligjor, u administruan nga trupi gjykues dhe iu nështruan debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike.

C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik

C.1. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë

- 20.** Në ankimin e datës 03.10.2019, sikurse edhe në parashtrimet e datës 02.06.2021, Komisioneri Publik kërkoi që në analizën financiare në Kolegj: a) të përfshiheshin shpenzimet për jetesë, transport dhe qira, gjatë periudhës së punësimit të subjektit në Përmet dhe Gjirokastër, të deklaruara nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; b) të mos reduktoheshin këta zëra nga shpenzimet në analizën financiare, me arsyetimin se përveç se nuk përputheshin me aktet e administruara në dosje, ishin edhe në tejkalim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit; dhe c) të mos përfshiheshin dietat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtyre viteve, me arsyetimin se dietat janë të destinuara për mbulim të shpenzimeve për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme profesionale, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë dhe jo për mbulimin e shpenzimeve personale. Rrethanat e mësipërme të parashtruara nga Komisioneri Publik, Kolegji i çmoi të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe, bazuar në nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji vlerësoi t'i merrte në shqyrtim.
- 21.** Në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues të Kolegjit dhe në funksion të shkaqeve të ankimit dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit, sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurive, u llogaritën të ardhurat dhe shpenzimet, pasuritë dhe likuiditetet e subjektit të rivlerësimit që do të renditen më poshtë.
- 21.1.** Për sa u përket të ardhurave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në analizën financiare të Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit, u llogaritën vlerat që rezultuan nga vërtetimet e institucioneve përkatëse, nga kredia në {***} Bank dhe kredia në Bankën {***}, si dhe të ardhurat e përfituara nga nxjerrja jashtë përdorimit e automjetit, përkatësisht:

- a) vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet për z. Ramiz Lala (dosja e ILDKPKI-së, aneksi 4/6);
- b) vërtetimi nr. {***} prot., datë 23.01.2017, i lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjirokastër për z. Ramiz Lala (dosja e ILDKPKI-së, aneksi 4/6);
- c) vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare (nuk ka datë) për znj. V. L., i lëshuar nga Zyra e Punës Kukës (dosja e ILDKPKI-së, aneksi 4/10);
- ç) vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare (nuk ka datë) për znj. V. L., i lëshuar nga DART – Tiranë dhe Qendra Ek. e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (dosja e ILDKPKI-së, aneksi 4/10);
- d) kredia në {***}Bank sipas “Kontratë Kredie Bankare”, datë 29.04.2011 dhe lëvizjet e llogarisë bankare;
- dh) kredia në Bankën {***} sipas “Kontratë Kredie Bankare”, datë 01.10.2014 dhe lëvizjet e llogarisë bankare;
- e) të ardhurat e përfitura nga nxjerrja jashtë përdorimit e automjetit, sipas faturës tatimore për shitjen hekur për skrap (dosja e ILDKPKI-së, aneksi 4/6).

21.2. Për sa upërket shpenzimeve të kryera, në analizën financiare të Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit u llogaritën shpenzimet ejetesës sipas standardeve të përcaktuara nga ILDKPKI-ja dhe INSTAT-i¹⁶ për familjet e përbëra nga katër persona, në rastin konkret, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe tre fëmijët, shpenzimet e kryera veçmas nga subjekti i rivlerësimit për jetesë, transport dhe qira, sikurse këto rezultuan nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe kontratat e qirasë në qytetin e Përmetit dhe tëGjirokastrëstë paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹⁷, shpenzimet e qirasë për apartamentin në Tiranë në vitin 2011¹⁸, shpenzimet e kredive, pagesat e tyre, si principal, interesa dhe komisione, sipas lëvizjeve të llogarive bankare në {***} Bank dhe në Bankën{***}¹⁹, shpenzime të udhëtimit të nxjerra nga sistemi TIMS dhe për pushimet, të llogaritur në përputhje me metodologjinë e aplikuar në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit²⁰, shpenzimet për udhëtimin në vitin 2014, në 159 euro (ose ekuivalenti prej 22.260 lekësh)²¹, shpenzimet e shkollimit sipas deklaratimeve të subjektit dhe vërtetimeve nga shkolla“{***}”, Tiranë dhe Universiteti {***}²², shpenzime të tjera sigurimi e rivlerësimi²³, si dhe shpenzimet e mobilimit sipas deklaratimeve të subjektit në pyetësorin nr. 1²⁴.

¹⁶Dërguar Kolegjit me shkresën nr. {***} prot., datë 4.3.2019. Referuar të dhënave bazë për konsumin vjetor për frymë dhe numrin e personave të njësisë familjare, marrë nga INSTAT-i, përkatësisht: për periudhën 2008 - 2011 nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (LSMS 2008); për periudhën 2014-2016 nga anketa e buxhetit të familjes (ABF 2014/2015/2016).

¹⁷Sipas kontratave të qirasë me znj. M. D., datë 04.01.2011 dhe me znj. L.Gj., datë 01.12.2013, 22.01.2015, 26.12.2015.

¹⁸Sipas aktmarrëveshjes me z. A. D., datë 01.11.2010.

¹⁹Lëvizjet në llogaritë bankare, në {***}Bank bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision, nr. {***} prot., datë 4.2.2019 dhe në {***} Bank bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision, nr. {***}prot., datë 13.2.2019.

²⁰Referuar paragrafit 27.12.10 të vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, me subjekt rivlerësimi EdmondIslamaj.

²¹Referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe vërtetimit të agjencisë turistike “{***}”, datë 16.07.2019, bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore.

²²Vërtetim shkolla jopublike “{***}”, Tiranë me nr. {***} prot., datë 21.03.2019 dhe vërtetim i Universitetit {***} me nr. {***} prot., datë 25.03.2019, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr.2.

²³Sipas lëvizjeve në llogarinë në {***} Bank të subjektit të rivlerësimit në datën 01.07.2011, prej 27.896 lekësh, për tatim nga rivlerësimi dhe shpenzime sigurimi sipas policave bashkëlidhur përgjigjes së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, dërguar Komisionit, nr. {***} prot., datë 4.02.2019.

²⁴Sipas shpjegimeve në pyetësorin nr. 1, pyetja nr. 11.

21.3. Për sa u përket investimeve për blerjen e pasurive, në analizën financiare të Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, u llogaritën shpenzimet e kryera, përkatësisht për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vitet 2011 dhe 2014²⁵, sipas kësteve të paguara, për blerjen e apartamentit dhe blerjen e autoveturës në vitin 2014²⁶.

21.4. Për sa u përket likuiditeteve në *cash*, në analizën financiare të Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, u llogaritën vlerat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, në vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, ndërsa për sa u përket likuiditeteve në llogaritë bankare, u përfshinë vlerat që rezultuan nga gjendjet e llogarive sipas vërtetimeve përkatëse të lëshuara nga institucionet bankare²⁷.

22. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj nga Njësia e Shërbimit Ligjor, duke llogaritur të ardhurat e dokumentuara, shpenzimet, investimet dhe likuiditetet në *cash* dhe gjendjet bankare si më sipër, subjekti i rivlerësimit në vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, rezultoi me mungesë burimesh financiare të ligjshme për justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në shumën totale prej (-) 939.061 lekësh, e shpërndarë respektivisht, për vitin 2011, në vlerën -250.928 lekë, për vitin 2014, në vlerën -326.036 lekë, për vitin 2015, në vlerën -64.841 lekë, dhe për vitin 2016, në vlerën -297.256 lekë.
23. Komisioneri Publik, në parashtrimet e datës 22.06.2021 dhe bisedimet përfundimtare të datës 07.07.2021, nuk paraqiti kundërshtime për analizën financiare të kryer në Kolegj nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila sipas Komisionerit Publik kishte përmbushur shkaku e ankimit për rivlerësimin e zërave financiarë dhe pranoi rezultatin e analizës financiare prej (-) 939.061 lekësh, si mungesë të burimeve të ligjshme për mbulimin e investimeve, shpenzimeve dhe kursimeve.
24. Në vijim, bazuar në nenin 45, pika 1 eligjit nr. 84/2016²⁸ dhe në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit për të aplikuar çdo skenar të mundshëm garantist²⁹, me qëllimin për të përmbushur detyrimin ligjor për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e kontrollit të pasurive, Kolegji mori në shqyrtim edhe kundërshtimet/prapësimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me analizën financiare të Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit.
25. Ndryshe nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi analizën financiare të Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit për vitet 2011, 2014, 2015, 2016, duke shpjeguar se

²⁵Referuar vërtetimit nr. {***} prot., datë 26.03.2019, të shitësit "{***}".

²⁶Referuar kontratës së blerjes së autoveturës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.07.2014, dosja e ILDKPKI-së, aneksi 4/9.

²⁷Të dhënat e vërtetimeve bankare dhe lëvizjet e llogarive bankare në {***} Bank bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision, nr. {***} prot., datë 4.2.2019, në {***} Bank, bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision nr. {***} prot., datë 13.2.2019, në {***} Bank, bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision nr. {***} prot., datë 6.2.2019, në {***} Bank, bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision nr. {***} prot., datë 31.1.2019, në {***} Bank, bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision nr. {***} prot., datë 1.02.2019, në {***}, bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision nr. {***} prot., datë 13.3.2019, në {***} Bank, bashkëlidhur shkresës dërguar në Komision nr. {***} prot., datë 21.02.2019.

²⁸Neni 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: "1. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit".

²⁹Referuar vendimeve nr. 1, datë 12.01.2021 dhe nr. 8, datë 09.03.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Posaçëm, me subjekte rivlerësimi përkatësisht znj. Albina Spaha dhe z. Idriz Mulkurti.

shpenzimet e arredimit dhe të mobilimit të banesës, ishin kryer të shpërndara në trivite, përkatësisht 700.000 lekë në vitin 2011, dhe pjesa tjetër në vijim, dhe duke pretenduar se në zërin e të ardhurave në analizën financiare nuk ishin përfshirë të ardhurat nga prodhimet bujqësore dhe blektorale³⁰, dietat në funksion të shërbimit³¹ dhe bonusi i kredisë prej 18.500 lekësh në vitin 2011³².

26. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e mobilimit dhe arredimit ishin kryer të shpërndara në vitet 2011 - 2013, Kolegji vëren senë deklaratën periodike/vjetore 2011 dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e kredisë konsumatore nga {***} Bank në datën 29.04.2011, për mobilimin e shtëpisë, në shumën prej 925.000 lekësh, me afat 84 muaj, deklaruar përdorimi i kredisë për mobilimin e shtëpisë në deklaratën *vetting*, në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”.

26.1. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera totale e arredimit dhe e mobilimit ishte në shumën totale prej 950.000 lekësh, ndërsa në përgjigje të rezultateve hetimore, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shpenzimi i arredimit e mobilimit nuk i përkiste vetëm vitit 2011, por dhe vitit 2012, përkatësisht: “[...] dua të theksoj se arredimi shtëpisë në shumën 950.000 lekë nuk i përket vetëm vitit 2011, por ky arredim është kryer dhe në vitin 2012. Siç kemi treguar në përgjigje të pyetësorit në fund të vitit 2011, na është bërë dorëzimi i banesës nga sipërmarrësi, dhe në fund të dhjetorit kemi hyrë në banesë. Arredimi i shtëpisë ka përfunduar pas hyrjes në banesë që i përket edhe periudhës 2012”.

26.2. Bazuar në nenin 1, pika 1 e kontratës së kredisë, datë 29.04.2011, me {***} Bank, Kolegji i rezulton se qëllimi i dhënies së kredisë nga banka ishte përdorimi nga bashkëkredimarrësi, përkatësisht subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, për arsye personale.

26.2.1. Në kushtet kur nuk rezulton ndryshe nga kontrata e kredisë bankare, bazuar në rrethanat e mësipërme dhe në nenin 32, pika 5³³, dhe nenin 49, pika 1, germa “b” eligjit nr. 84/2016³⁴, Kolegji vlerëson se kredia konsumatore e marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në vitin 2011, ka pasur për destinacion mobilimin e shtëpisë, ndërsa shpërndarja e shpenzimeve të mobilimit, përkatësisht në shumën prej 700.000 lekësh në vitin 2011, ka qenë një e drejtë e

³⁰Përkatësisht në analizën financiare paraqitur në prapësimet e seancës së datës 22.06.2021 (tabela në Variantin I dhe Variantin II), në vlerat prej 210.500 lekësh në vitin 2011, 207.800 lekësh në vitin 2014, 206.000 lekësh në vitin 2015, 205.800 lekësh në vitin 2016, sipas tabelave Varianti I dhe Varianti II, rreshti “Ref: 7”. Vlerat i janë referuar aktekspertizës agronomike, datë 25.03.2020, për fermën në pasuritë nr. {***} dhe {***}, Paskuqan, nga Prot. Dr. Agr. B. M., Ekspert Vlerësues Pas. Paluajtshme Vp. {***}, Dr. Agr. B. Q., Ekspert Vlerësues Pas. Paluajtshme Vp. {***}, Agr. I. Y., sjellë nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur prapësimeve të datës 28.05.2021 në Kolegji

³¹Përkatësisht në analizën financiare paraqitur në prapësimet e seancës së datës 22.06.2021 (tabela në Variantin I) dhe në konkluzionet përfundimtare, datë 07.07.2021, në vlerat prej 182.400 lekësh në vitin 2011, 170.424 lekësh në vitin 2014, 99.500 lekësh në vitin 2015, 24.015 lekësh në vitin 2016, sipas dokumenteve bankare siç referon subjekti i rivlerësimit.

³²Përkatësisht, sipas transaksioneve bankare në datën 02.05.2011, duke u kredituar në llogarinë bankare me shumën 18.500 lekë, me përshkrimin “bonus nga kredia {***}”.

³³Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimt”.

³⁴Neni 49, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelimt ka të drejtë: [...] b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku”.

pakushtëzuar e subjektit të rivlerësimit, e cila, bazuar në nenin 49, pika 4 eligjit nr. 84/2016³⁵, nuk bie ndesh me provat e tjera të administruara në dosje.

26.3. Kolegji vëren shpenzimet emobilimit dhe arredimit, të llogaritura nga Komisioninë analizën financiare të vitit 2011, janë në shumën totale prej 950.000 lekësh. Duke kryer shpërdarjen e shpenzimeve të mobilimit e arredimit, sipas dokumenteve të mësipërme dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht duke vlerësuar se në vitin 2011 shpenzimet e kryera për mobilim dhe arredim ishin në shumën prej 700.000 lekësh, Kolegjit i rezulton se diferenca negative e pambuluar me burime të ligjshme në këtë vit do të reduktohej nga shuma prej (-) 250.928 lekësh duke u minimizuar në shumën prej (-) 928 lekësh të vitit përkatës, dhe totali i balancës financiare të viteve 2011, 2014, 2015, 2016 do të reduktohej nga shuma prej (-) 939.061 lekësh në shumën prej (-) 689.061 lekësh.

26.4. Përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vlerëson se bonusi i kredisë prej 18.500 lekësh në vitin 2011, ishte pagesë e një shpenzimi në funksion të ripagimit të kredisë prej 925.000 lekësh të marrë nëpërmjet kontratës së kredisë, datë 29.04.2011, nga {***} Bank, por jo e ardhur në këtë vit. Sipas lëvizjeve të llogarisë bankare në {***} Bank, konfirmohet kjo shumë e kredituar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 02.05.2011. Kjo shumë konstatohet se ka kompensuar një shpenzim të kryer nga subjekti i rivlerësimit disa ditë më parë, në datën 29.04.2011, në ditën e lëvritimit të kredisë, duke përmbushur dhe kontratën e kredisë së datës 29.04.2011³⁶, “Neni 3 - Interesi, periudha e interesit dhe komisionet”, paragrafi 7, në të cilin shprehet se *kredimarrësi do të paguajë një komision administrativ prej 0.00 lekësh, ipagueshëm në ditën e disbursimit të parë, min. 0 lekë, maks. 0 lekë*. Pra, bonusi i kredisë prej 18.500 lekësh, pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si e ardhur në vitin 2011, nuk i përket një të ardhure shtesë që të konsiderohet në analizën financiare të vitit 2011, por një e ardhur që ka kompensuar një shpenzim të kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 29.04.2011, sipas lëvizjeve të llogarisë bankare, pra efekti i tij nuk ka vlerë në analizën financiare të vitit 2011.

26.4.1. Megjithatë, nëse do t'i llogaritnim të shpërndara në vitshpenzimet e mobilimit dhe arredimit, diferenca negative për vitin 2011 do të rezultonte minimaliste, në shumën prej (-) 928 lekësh dhe, rrjedhimisht, jodomethënëse për të treguar nivelin e ligjshmërisë së burimeve të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit.

27. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në analizën financiare të viteve 2011, 2014, 2015, 2016, të ardhurat nga prodhimet bujqësore dhe blektorale, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet aktit të ekspertizës agronomike, datë 25.03.2020, të paraqitur në Kolegji, pretendon se ka realizuar të ardhurat si në vijim: a) për vitin 2011, në shumën prej 210.500 lekësh; b) për vitin 2012, në shumën prej 206.000 lekësh; c) për vitin 2013, në shumën prej 205.200 lekësh; ç) për vitin 2014, në shumën prej 207.800 lekësh; d) për vitin 2015, në shumën prej 206.000 lekësh; dhe dh) për vitin 2016, në shumën prej 205.800 lekësh.

27.1. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegji vërtetimin nr. {***} prot., datë 24.05.2021, të Njësisë Administrative Paskuqan, nga i cili rezulton se z. Ramiz Lala kishte bërë

³⁵Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “ 4. Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”.

³⁶Në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi 4/7.

pagesat e taksës së tokës bujqësore nga viti 2015 - 2021, dhe vërtetimin nr. {***} prot., datë 05.02.2020, të Njësisë Administrative Paskuqan, sipas të cilit banorët e kësaj zone, prodhimet bujqësore dhe blektorale i përdorin për nevojat e veta familjare, dhe tepricat e këtyre produkteve nga veprimtaria bujqësore/blektorale, zakonisht i shesin jashtë kësaj zone në mënyrë ambulatorë.

27.2. Bazuar në nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016³⁷ dhe në përputhje me jurisprudencën e deritanishme³⁸, Kolegji vlerëson se pretendimet, prapësimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për krijimin e të ardhurave nga kultivimi i kulturave bujqësore dhe blektorale, edhe pse deri në një masë të besueshme, mbetën në nivel deklarativ dhe nuk gjetën mbështetje të plotë në dokumentacion.

27.2.1. Kolegjit i rezultonte subjekti i rivlerësimit ka vërtetuar se në pronësi të tij ka tokë bujqësore në të cilën ka kultivuar apo kultivon prodhime bujqësore dhe blektorale, nëpërmjet së cilës ka ndihmuar apo ndihmon ekonominë familjare, çka, bazuar në nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016³⁹, rezulton i besueshëm shpjegimi se të ardhurat nga toka bujqësore mund të kenë ndikuar apo ndikojnë në reduktimin e shpenzimeve të jetesës së anëtarëve të saj. Referuar analizës financiare në funksion të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, duke mos konsideruar dietat siç trajtohen në paragrafin më poshtë dhe duke konsideruar pretendimet për shpenzime jetese më të ulëta për shkak të kultivimit të kulturave perimore nga vetë familja e subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të viteve 2011, 2014, 2015, 2016, nëse do të konsideronim kultivimin nga vetë familja të kulturave perimore, prej mesatarisht 170.000 lekë/vit⁴⁰ sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në prapësimet e datës 28.05.2021, sjellë në Kolegj⁴¹, si dhe ashtu si ka pretenduar dhe në përgjigje të rezultateve hetimore, pra një pjesë e shpenzimeve të jetesës e cila është përballuar nga kultivimet që ka kryer familja, analiza financiare më sipër (referuar paragrafit nr.22 më sipër) do të rezultonte me ulje të diferencave

³⁷Neni 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: "1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë: a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2, të këtij ligji; b) të mbledhë deklarata nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku; c) të marrë dokumente të tjera shkresore, sipas formave të parashikuara në ligj ose dokumenteve të marra nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; ç) të këqyrë dhe të kontrollojë sende të luajtshme ose të paluajtshme, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente".

³⁸Referuar vendimeve të Kolegjit nr. 9/2020 dhe nr. 26/2020. Përkatësisht me subjekte rivlerësimi z. Alfred Gjoni dhe z. Çlirim Shahini.

³⁹Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: "4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes".

⁴⁰Referuar aktit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur përgjigjeve të rezultateve hetimore, "Pasqyrën e të ardhurave nga kultivimi i kulturave perimore dhe nevoja familjare" e përgatitur nga specialisti agr.Z. N., në të cilën janë konsideruar për çdo vit të ardhura (prodhimi x çmimi/ kg) duke konsideruar shpenzime mujore dhe pagë punëtori/ ditë pune – të cilat subjekti pretendon se nuk janë shpenzime që janë kryer pasi puna është kryer nga bashkëshortja e tij - nga të cilat mbetet një vlerë neto prej mesatarisht, për vitet 2011-2016, 170.125 lekësh/ vit [mesatare e diferencave të të ardhurave të llogaritura çdo vit (kg x çmimi/kg), zbritur shpenzimet çdo vit, pa konsideruar shpenzime punëtori kryer nga bashkëshortja, pra për vitin 2011 prej 171.750 lekësh (diferenca të ardhura 214.250 lekë – shpenzime 42.500 lekë); për vitin 2012 prej 149.500 lekësh (diferenca të ardhura 187.000 lekë – shpenzime 37.500 lekë); për vitin 2013 prej 163.800 lekësh (diferenca të ardhura 210.500 lekë – shpenzime 46.700 lekë); për vitin 2014 prej 176.900 lekësh (diferenca të ardhura 219.900 lekë – shpenzime 43.000 lekë); për vitin 2015 prej 172.900 lekësh (diferenca të ardhura 216.900 lekë – shpenzime 44.000 lekë); për vitin 2016 prej 185.900 lekësh (diferenca të ardhura 230.400 lekë – shpenzime 44.500 lekë)].

⁴¹Në faqen 19 të prapësimeve, datë 28.05.2021.

negative ndër vite. Subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar saktë dhe sipas kërkesave të ligjit, në deklaratat periodike vjetore, ashtu edhe në deklaratën *vetting*, të ardhurat nga bujqësia. Por, duke konsideruar deri në një masë të besueshme faktin se ekonomia familjare është ndihmuar nga kultivimi i prodhimeve bujqësore, diferenca negative e konstatuar mbi bazë dokumentesh [trajtuar në paragrafët mësipër] nuk duket se është realisht ajo.

28. Për sa i përket përfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga dietat, subjekti i rivlerësimit pretendon/prapëson dhe shpjegon se ka përfituar përkatësisht vlerat prej 182.400 lekësh në vitin 2011, prej 170.424 lekësh në vitin 2014, 99.500 lekësh në vitin 2015 dhe 24.015 lekësh në vitin 2016, sipas përfshirjes në analizën financiare të viteve në tabelën e Variantit I, në prapësimet në seancën e datës 22.06.2021⁴². Sipas akteve në fashikujt e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit, sjellë nga Komisioni, rezultojnë se sipas lëvizjes së llogarive në {***} Bank dhe {***} Bank të subjektit të rivlerësimit, janë kredituar në llogari vlerat me përshkrimin “dieta”: a) në vitin 2011, nëpërmjet {***}Bank, shuma prej 182.400 lekësh; b) në vitin 2014, nëpërmjet {***}Bank, shuma prej 81.500 lekësh (në datat 04.04.2014, 10.04.2014 dhe 30.04.2014); c) në vitin 2014, nëpërmjet {***} shuma prej 86.500 lekësh (në datat 30.05.2014, 18.07.2014, 20.10.2014 dhe 29.12.2014), në total për vitin 2014 prej 168.000 lekësh; ç) në vitin 2015, nëpërmjet {***} shuma prej 99.500 lekësh; dhe d) në vitin 2016, nëpërmjet {***} shuma prej 24.015 lekësh. Referuar pretendimeve të subjektit në prapësimet lidhur me analizën paraprake financiare për vitet 2011, 2014, 2015, 2016, përgatitur nga Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit, paraqitur në seancën e datës 22.06.2021, në të cilën ka pretenduar se duhet të konsiderohen dietat e kaluara në llogarinë e tij bankare ose si të ardhura, ose si ulje e shpenzimeve të jetesës, Kolegji e vlerësoi këtë situatë si vijon. Referuar këtij pretendimi në prapësimet e paraqitura në seancën e datës 22.06.2021, ka paraqitur dy variante analizë financiare në formë tabele, Varianti I ku dietat i ka përfshirë në analizën financiare të viteve si të ardhura dhe Varianti II në të cilin nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga dietat. Në vijim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e dietave në analizën financiare, konstatohet se nuk janë deklaruar në deklaratën *vetting*, si dhe nuk janë konfirmuar veçmas në vërtetimet e pagave nga institucionet përkatëse⁴³, por, sipas akteve në fashikuj, referuar dietave të kredituara në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit, detajuar sa më sipër, nëse do të konsideroheshin se kanë mbuluar shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, diferenca negative e rezultuar në analizën financiare të viteve 2011, 2014, 2015, 2016 do të ulej, duke e përmirësuar situatën.

28.1 Në përputhje me jurisprudencën e deritanishme⁴⁴, Kolegji vlerëson se, duke pasur parasysh natyrën e dietave, si kategori burimesh financiare që teorikisht krijojnë pasuri, dhënë për të mbuluar shpenzime të pritshme apo të kryera, ato nuk mund të argumentohen si burim të ardhurash, pasi janë pagesë e një shpenzimi jetik të kryer. Por gjithashtu pretendimi i subjektit të rivlerësimit se këto dieta kanë ulur shpenzimet, nuk ishte i mundur të vlerësohej pasi, referuar akteve në fashikuj, nuk ka informacion se cili ka qenë qëllimi i përfitimit të dietave, pra mungon

⁴²Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dhe analize financiare ndër vite, Varianti II, duke mos marrë në konsideratë të ardhurat nga dietat.

⁴³Vërtetimet e pagave për vitin 2011 dhe vërtetimi i pagës nr. {***} prot., datë 23.01.2017, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë për vitet 2014-2016 nuk konfirmojnë dietat e kaluara subjektit të rivlerësimit si shumë totale apo dhe llojet e dietave të përfituara, por dietat konfirmohen të kaluara në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit me emërtimin “dieta”, nga lëvizjet në llogaritë bankare ndër vite.

⁴⁴Referuar vendimeve të Kolegjit nr. 01/2021, me subjekt rivlerësimi, znj. Albina Spaha, nr. 07/2019, me subjekt rivlerësimi Edison Sadiku, nr. 01/2020, me subjekt rivlerësimi Admir Belishta, nr. 04/2020, me subjekt rivlerësimi A. Dollapaj.

konfirmimi dhe informacioni nga institucionet⁴⁵prejtëcilavei ka përfituar subjekti i rivlerësimit dhe se cilat shpenzime kanë mbuluar dietat apo edhe qëllimi i marrjes së tyre, pasi dietat e përfituara konfirmohen vetëm të kaluara në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit.

29. Në konkluzion të analizës faktike dhe ligjore si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 52, pika 1 eligjit nr. 84/2016⁴⁶, i udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit⁴⁷, konstaton se mungesa e burimeve financiare të ligjshme për mbulimin e investimeve, shpenzimeve dhe kursimeve që rezultoi nga analiza financiare e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit, e cila në vetvete edhe në mënyrë kumulative, parë edhe në funksion të prapësimeve/shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk përfaqësonte një vlerë të konsiderueshme, nuk ishte e kufizuar në një vit të vetëm, por ishte e shtrirë në katër vite dhe, si pasojë, me një diferencë negative edhe më të reduktuar në vitet përkatëse dhe jodomethënëse për të treguar nivelin e ligjshmërisë së burimeve të subjektit të rivlerësimit, është e tillë që nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë. Për pasojë, ashtu si Komisioni, në kuptim të nenit 59, paragrafi 3i ligjit nr. 84/2016, edhe Kolegji çmon se ekzistojnë arsyet e mosmarrjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas kërkesave të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi rrezulton se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit 59, paragrafi 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

C.2. Kontrolli i kriterit të aftësive profesionale

30. Bazuar në nenin 45, pika 1 eligjit nr. 84/2016⁴⁸, me qëllim për të përmbushur detyrimin ligjor për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e paraqitura nga Komisioneri Publik, për të cilat përfundimisht Komisioneri Publik vlerësoi se nuk ishin të tilla që subjekti i rivlerësimit të konsiderohej si i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e gjyqtarit, sipas nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
31. Në lidhje me çështjen që i përket vendimit nr. {***}, datë 28.03.2017, të GjAShPGj-së, me palë paditëse A. Gj. dhe palë të paditur DPPSh-në, pas vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues të datës 02.06.2021, GjAShPGj-ja dërgoi në Kolegji fashikullin e gjykimit të çështjes të administruar nga kjo gjykatë⁴⁹.

31.1. Për sa i përket statusit procedural të kësaj çështjeje, Kolegji konstatoi se vendimi nr. {***}, datë 28.03.2017, i GjAShPGj-së, me të cilin ishte vendosur pranimi i kërkesëpadisë dhe detyrimi

⁴⁵ Vërtetimet e pagave për vitin 2011 dhe vërtetimi i pagës nr. {***} prot., datë 23.01.2017, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë për vitet 2014-2016 nuk konfirmojnë dietat e kaluara subjektit si shumë totale apo dhe llojin e dietës së përfituar (si dhe çfarë shpenzimesh ato mbulojnë), por megjithatë nga lëvizjet në llogaritë bankare konfirmohet marrja e këtyre dietave nga subjekti ndër vite.

⁴⁶ Neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “1. Komisioni dhe Kolegji i Apelit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit”.

⁴⁷ Referuar vendimit nr. 31, datë 18.11.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me subjekt rivlerësimi Elvin Gokaj.

⁴⁸ Neni 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “1. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit”.

⁴⁹ Referuar shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 08.06.2021, të GjAShPGj-së.

i DPSH-së t'i njihete paditësit A.Gj. gradën policore “Drejtues”, kishte marrë formë të prerë pa u ankimuar nga DPSH-ja, e cila në gjykim kishte cilësinë e palës së paditur⁵⁰.

31.1.1. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se kjo çështje nuk ishte në shqyrtim, në kuptim të nenit E, pika 2, fjalia e fundit e Aneksit të Kushtetutës⁵¹, dhe për këtë arsye vendosi të marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura nga Komisioneri Publik.

31.2. Nga materialet e fashikullit të gjyqimit të çështjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 28.03.2017, të GjASHPGj-së, Kolegjit i rezultoi se me kërkesën e datës 17.02.2017, z. A. Gj., me detyrë shëf i Komisarariatit të Policisë Gjyrokastër, i ishte drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit Gjyrokastër (në vijim “DVPSHGj”), me qëllim fitimin e gradës “Drejtues”.

31.2.1. Në vijim, me anë të shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 22.02.2017, DVPSHGj-ja ka informuar z. A. Gj. se grada “Drejtues” që ai kërkonte, nuk i korrespondonte funksionit që askohe kryente.

31.2.2. Nuk rezulton nga materialet e dosjes që z. A. Gj. të jetë ankuar kundër kthim përgjigjes së DVPSHGj-së. Pas kthim përgjigjes së DVPSHGj-së, z. A. Gj., në datën 01.03.2017, iu drejtua GjASHPGj-së, me kërkesëpadinë me objekt: “Detyrimin e palës së paditur (Drejtoria e Policisë së Shtetit) t'i njohë paditësit gradën *Drejtues*”.

31.3. Kolegji vëren se gjen mbështje në prova pretendimi i Komisionerit, se nuk rezultonte që subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, të kishte arsyetuar për shterimin e ankimit administrativ, sipas nenit 60, pika 1 eligjit nr. 108/2014, datë 31.07.2014, “Për policinë e shtetit”⁵² (në vijim “ligji nr. 108/2014”) dhe nenit 16, pika 1 eligjit nr. 49/2012⁵³.

31.3.1. Si pasojë, Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes në GjASHPGj, ka marrë në shqyrtim dhe ka pranuar përfundimisht padinë e palës paditëse A. Gj. për dhënien e gradës “Drejtues i parë”, pa hetuar nëse drejtori i DPSH-së kishte miratuar urdhrin për fillimin e aplikimeve për këtë gradë, sipas parashikimit të nenit 54 të ligjit nr. 108/2014⁵⁴.

31.4. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, nuk ka hetuar plotësisht procedurën e ankimit administrativ, por është njafuar me konstatimin e përgjigjes negative të DVPSHGj-së, por në kushtet kur edhe vetë pala e paditur, DPSH-ja, nuk e ka

⁵⁰Shih shënimin e datës 07.06.2021, të kancelares së GjASHPGj-së, në fund të vendimit nr. {***}, datë 28.03.2017, të GjASHPGj-së.

⁵¹Neni E, pika 2, fjalia e fundit e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.”

⁵²Neni 60, pika 1 e ligjit nr. 108/2014, parashikon se: “1. Punonjësi i policisë ka të drejtën e ankimit në komisionin e apelimit në çdo fazë të procesit për fitimin në gradë. Ushtrimi i së drejtës së ankimit brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e Policisë pezullon nxjerrjen e urdhrin të Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe efektet e aktit të vlerësimit të komisionit të gradimit që është ankimuar”.

⁵³Neni 16, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, parashikon se: “1. Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ”.

⁵⁴Neni 54 (Fitimi i gradës) i ligjit nr. 108/2014 parashikon se: “1. Fitimi i gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi. Çdo vit evidentohen nevojat për çdo gradë për vitin pasardhës. Drejtori i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave dhe prioriteteve, miraton urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës respektive. Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit e kanë të gjithë punonjësit e policisë që plotësojnë kriteret e vendosura në këtë ligj”.

ankimuar vendimin përfundimtar të GjAShPGj-së, përfshirë edhe pjesën e kontrollit të plotë gjyqësor të ezaurimit të ankimit administrativ, Kolegji vlerëson se ky tregues nuk mund të ngrihet në nivelin e mosrespektimit normalisht të të drejtave të palëve, në kuptim të nenit 44, pika “c” eligjit nr. 84/2016⁵⁵.

31.5. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik për dhënien pa konkurs të gradës “Drejtues”, Kolegji vëren se praktika gjyqësore ka qenë e ndryshme në një shkallë të tillë që, për njësimin e saj, është vënë në lëvizje edhe Gjykata e Lartë.

31.5.1. Kështu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka çmuar të nisë procedurën e gjykimit për njësimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për njësim, shprehimisht: “A mund të fitohet gjyqësisht grada policore për shkak të plotësisimit të kriterit të vjetërsisë në gradë dhe/ose ushtrimit të funksionit përkatës për gradën e pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së vlerësimit konkurrues nga një komision gradimi? [...]”⁵⁶.

31.5.2. Kolegji konstaton se dhënia e gradave policore pa konkurs, ka të bëjë me themelin e çështjes, e cila në kohën e gjykimit ishte shtruar për njësim në Gjykatën e Lartë dhe, për këtë arsye, Kolegji, bazuar në nenin 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, çmon të mos e marrë në shqyrtim këtë tregues, i cili përjashtohet nga shkaqet për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm, në kuptim të nenit 44, pika “c” e ligjit nr. 84/2016.

32. Në lidhje me çështjen që i përket vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjAShPGj-së, me palë paditëse S. R. dhe palë të paditur DPPSh-në, pas vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues, datë 02.06.2021, GjAAT-ja dërgoi në Kolegj kopjen e fashikullit të GjAShPGj-së, pa përfshirë në të dokumentet e sjella në Kolegj, kopjen e ankimit apo çdo akt tjetër procedural që kishte lidhje me shqyrtimin e ankimit nga GjAAT-ja⁵⁷.

32.1. Për sa i përket statusit procedural të kësaj çështjeje, Kolegji konstatoi se ankimi kundër vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjAShPGj-së, gjendej në proces shqyrtimi para GjAAT-së.

32.1.1. Në përputhje me jurisprudencën e deritanishme, Kolegji vlerëson se parashikimi i nenit E të Aneksit të Kushtetutës nuk lidhet me statusin në tërësi të çështjes, por me ato çështje të cilat janë në proces shqyrtimi nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, dhe çështja në fjalë nuk është në këtë status, pasi subjekti i rivlerësimit ka dhënë për çështjen një vendim përfundimtar dhe, në kuptim të dispozitave procedurale, do të kishte ndalesë të rigjykonte këtë çështje⁵⁸.

32.1.2. Në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, për të vlerësuar çështjen për aq sa subjekti i rivlerësimit kishte dhënë vendimin përfundimtar, Kolegji vendosi të mos kërkonte nga GjAAT-

⁵⁵Neni 44, pika “c” e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “Relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve e tjera ligjore. Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë: [...] c) “I papërshtatshëm”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës”.

⁵⁶http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Njoftim_per_publicun_10556_1-752.php

⁵⁷Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 07.06.2021, të GjAAT-së.

⁵⁸Referuar vendimit nr. 16/2021 të Kolegjit, paragrafi 22.8, me subjekt rivlerësimi Hysni Demiraj.

ja, kopjen e ankimit apo çdo akt tjetër procedural që kishte lidhje me shqyrtimin e ankimit nga GjAAT-ja, dhe që nuk kishin lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

32.2. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit kishte disponuar mbi kërkime gjyqësore të palës paditëse që rezultonin gjë e gjykuar, Kolegji vëren se në vendimin nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjAShPGj-së, me palë paditëse S. R. dhe palë të paditur DPPSh-në, është arsyetuar se: “Nga vetë pamja e objektit të kërkesëpadisë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe atij nëpërmjet të cilit Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka disponuar nëpërmjet vendimit {***}, datë 14.05.2018, rezultojnë se këto objekte nuk janë të njëjta. Pala e paditur, pas dhënies së vendimit të mësipërm gjyqësor nga Gjykata Administrative, ka disponuar me urdhrin objekt shqyrtimi gjyqësor për transferimin e paditësit. Kërkimi i paditësit në çështjen gjyqësore të mësipërme ka të bëjë me rregullimin e pasojave për shkak të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, urdhrin nr. {***}, datë 02.03.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Pala paditëse nëpërmjet kërimit objekt shqyrtimi gjyqësor kërkon shfuqizimin e urdhrin nr. {***}, datë 21.01.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për transferimin dhe emërimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”; detyrimin e organit administrativ, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, t’i njohë paditësit gradën policore Drejtues i parë nga data e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor, VKM-së nr. 893/2007, ta rikthejë në vendin e punës që i korrespondon grada policore Drejtues i parë dhe pagimin e pagës, vjetërsinë në punë, pagesën e kontributetve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe sigurimin për pension suplementar mbi bazën e pagës që i korrespondon gradës policore Drejtues i parë, nga data e lindjes së të drejtës”⁵⁹.

32.2.1. Për sa më sipër, Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjAShPGj-së, ka marrë në shqyrtim dhe i ka dhënë përgjigje pretendimit të palës së paditur në proces, DPPSh-së, në lidhje me shqyrtimin e gjësë së gjykuar.

32.2.2. Për këtë arsye, Kolegji, bazuar në përcaktimet e nenit 72, pika 4e ligjit nr. 96/2016, gjendet para pengesës ligjore për të marrë në shqyrtim pretendimin e ngritur nga Komisioneri në këtë gjykim, sepse vlerësimi i këtyre rrethanave nga Kolegji do të zëvendësonte interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit të çështjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjAShPGj-së, i cili ka vlerësuar se çështja që po gjykohej prej tij kishte objekt të ndryshëm me çështjen që parashtronte DPPSh-ja, ndërsa gjithashtu ka vlerësuar të rregullojë pasojat për shkak të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ⁶⁰.

33. Në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues, pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit për kriteret e kontrollit të pasurisë dhe të aftësive profesionale, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, dhe provat e marra gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe në legjisllacionin e zbatueshëm, arrin nëpërfundimet e mëposhtme.
34. Për kriterin evlerësimittë pasurisë, trupi gjykues çmon se konkluzionet e arritura nga vlerësimi i analizës financiare të kryer në Kolegj, në lidhje me mungesën e burimit financiar të ligjshëm për

⁵⁹Referuar f. 19 të vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjAShPGj-së.

⁶⁰Referuar f. 18 - 19 të vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjAShPGj-së.

të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, nuk u gjenden të mjaftueshme për t'u kualifikuar si deklarime të pamjaftueshme, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

35. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se, nisur nga statusiprocedural i çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të trajtuara nga Komisioneri Publik në ankim për shkak të informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe duke vlerësuar situatat e identifikuar në këto çështje, arrin në konkluzionin se ato nuk janë të mjaftueshme për të klasifikuar subjektin e rivlerësimit si të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e gjyqtaritsipas nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
36. Për kriterin e kontrollit të figurës, në gjykim nuk u pretenduan dhe nuk u konstatuan rrethana të ndryshme me Komisionin, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
37. Sa u përket dy çështjeve të sipërcituara, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i është drejtuar njëkohësisht edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për pasojë, ky informacion mund/duhet të trajtohet sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

37.1. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi i shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e Komisionerit, në funksion të informacioneve të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe dokumenteteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj të çështjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 14.05.2019, të GjASHPGj-së, duke u gjendur para pengesës së parashikuar nga neni 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, për të marrë në shqyrtim këto pretendime, nuk evidentoi shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, të tilla që të mund të ndryshonin vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, ose shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 59, pika 4, fjalia e parë e ligjit nr. 84/2016, në një kohë që rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, informacionin mbi shkeljet e pretenduara të subjektit të rivlerësimit, në kuadër të ligjit nr. 96/2016, ia ka paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe organit kompetent. Mbi këtë arsytim, Kolegji, duke respektuar pavarësinë dhe autonominë e organeve kompetente, nuk pranoi kërkimin e Komisionerit Publik për transferimin e çështjes për inspektim.

38. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, me të drejtë, Komisioni ka arritur në përfundimet se subjekti i rivlerësimit në mënyrë kumulative arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit dhe, me të drejtë, e ka konfirmuar në detyrë, në zbatim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 190, datë 26.07.2019, i Komisionit konsiderohet i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 26.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ramiz Lala.

- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, më datë 12.07.2021, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Natasha Mulaj dhe Rezarta Schuetz, nuk ishim dakord me vendimin e shumicës së trupit gjykues në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Ramiz Lala [(JR) nr. 50, datë 14.10.2019] mbi ankimin e Komisionerit Publik dhe votuam kundër për arsytet që do të shtjellojmë më poshtë.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka vendosur *konfirmimin në detyrë* të subjektit të rivlerësimit Ramiz Lala. Mbi ankimin e Komisionerit Publik (në vijim “Komisioneri”), kjo çështje u gjykua në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”). Shumica e trupit gjykues ka vendosur *lënien në fuqi* të vendimit të Komisionit objekt ankimi. Me vendimin e saj, shumica vlerësoi se:

(i) Për kriterin e pasurisë, nga vlerësimi i analizës financiare të kryer në Kolegj, mungesat e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, nuk u gjetën të mjaftueshme për t’u kualifikuar si deklarime të pamjaftueshme, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

(ii) Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, nisur nga statusi procedural i çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të trajtuara nga Komisioneri Publik në ankim, për shkak të informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe duke vlerësuar situatat e identifikuar në këto çështje, sa është konstatuar nuk është e mjaftueshme për të klasifikuar subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e gjyqtarit sipas nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

3. Në vijim shtjellohet qëndrimi ynë për secilin prej këtyre dy komponentëve, me argumentet e grupuara për secilin kriter të vlerësimit.

I. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

4. Në analizën financiare përfundimtare për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, Komisioni ka reduktuar zërin e pagesës së shpenzimeve dhe transportit për udhëtimet Përmet - Gjirokastrë dhe kthim, dhe zërin e pagesës së shpenzimeve të qirasë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk kishte ngritur pretendime në këtë drejtim.
5. Po ashtu, në analizën financiare të kryer nga Komisioni ishin zbritur shpenzimet për zërat ushqim, transport dhe fjetje, duke marrë në konsideratë vlerat monetare të dietave të kredituara në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit. Komisioneri kërkoi të rivlerësonte zërat e analizës financiare për periudhën gjatë viteve 2011, 2014, 2015 dhe 2016, si dhe të konkludonte mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme të ardhurat e deklaruar dhe shpenzimet e kryera.
6. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016 subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultonin me balancë negative, për të krijuar të ardhurat dhe për të kryer shpenzimet dhe pagesat me të ardhurat e ligjshme të dokumentuara. **për vlerën në total prej – 939.061 lekësh.** Shumica, në referencë të proporcionalitetit, konkludoi se shuma e mësipërme nuk përfaqësonte një vlerë të konsiderueshme, nuk ishte e kufizuar në një vit të vetëm dhe, sipasojë, një *diferencë negative jodomethënëse* për të treguar nivelin e ligjshmërisë së

burimeve të subjektit të rivlerësimit, që nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi në lidhje me kriterin e pasurisë.

7. Ndryshe nga shumica, vlerësojmë se zbatimi i parimit të proporcionalitetit për vlerën negative prej (-) 939.061 lekësh nga balanca e të ardhurave dhe shpenzimeve për katër vjet, nuk gjente vend në rastin e subjektit të rivlerësimit Ramiz Lala për disa arsye. Së pari, legjislatori nuk ka përcaktuar çfarë përbën një shumë proporcionalisht të ulët, duke e lënë vlerësimin në çmimin e gjykatës. Në këto kushte, logjikisht, vlerësimi për konfirmim në detyrë të një subjekti duke evokuar parimin e proporcionalitetit, mund të gjejë zbatim vetëm pas një analizeshumë të kujdesshme në të cilën Kolegji duhet të peshojë të gjithë faktorët e përfshirë, për të evituar çdo perceptim të mundshëm arbitrariteti dhe mungese rigoroze në trajtimin e subjekteve të ndryshme të rivlerësimit. Në këtë kuadër, proporcionaliteti duhet të vlerësohet në analizë të kriterëve objektive dhe lehtësisht të parashikueshme e standarde, në mënyrë që vendimmarrjet e institucioneve të rivlerësimit të evokojnë objektivin e procesit të rivlerësimit në pikën fundore: të rikthejnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
8. Në këtë kuadër, në vlerësimin tonë, proporcionaliteti duhet të analizohet pikësisht në qasjen më të drejtpërdrejtë e logjike, mbi bazën e raportit mes balancës negative mes të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit për vitet për të cilat Komisioneri Publik kërkoi saktësimin e analizës nga Kolegji, me pagën e subjektit të rivlerësimit për të njëjtën periudhë. Nga shqyrtimi i akteve në fashikull, rezulton që balanca negative [939.061 lekë] përbën mesatarisht 19,5%⁶¹ të pagave vjetore të subjektit të rivlerësimit në vitet me balancë negative. Në këto kushte, subjekti nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në një përqindje që mund të konsiderohet e papërfillshme e, për pasojë, “proporcionalisht” të diktojë përjashtimin e zbatimit të gjendjes së mungesës së burimeve. Me fjalë të tjera, nëse thuajse 1/5 e të ardhurave vjetore do të konsiderohen të atilla sa edhe në mungesë të tyre, ligjshmëria e mjaftueshmëria e burimeve është pa efekt në procesin e rivlerësimit, raporti mes burimeve të ligjshme dhe atyre të pajustificuara ligjërisht, që do të përdoren si standard që e çon një subjekt drejt shkarkimit, do të jetë arbitrar, i pabazuar në një diskrecion të njohur nga legjislatori për institucionet e rivlerësimit dhe në mospërputhje me standardin e përdorur nga Kolegji në jurisprudencën e tij të deritanishme.
9. Në përmbledhje të sa më sipër, vlerësuam se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton i besueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi ishte nëkushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar respektivisht nga nenet 61, pika 3 dhe 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Së fundmi, është i pabazuar zbatimi nga shumica i parimit të proporcionalitetit për balancën negative të konstatuar, e cila përbën thuajse 20% të të ardhurave të subjektit, mesatarisht në vitet në analizë. Ky konstatim, i parë së bashku me gjetjet [e mëposhtme] lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, tregon që subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë.

⁶¹ Më konkretisht, balancat negative të viteve në fjalë përbëjnë 26% të të ardhurave të subjektit në vitin 2011, 27% të të ardhurave në vitin 2014, 18% të të ardhurave të vitit 2015 dhe 17% të të ardhurave për vitin 2015.

II. Kriteri i vlerësimit profesional

10. Komisioneri Publik kërkoi që Kolegji të verifikonte ligjshmërinë e vendimmarrjeve të subjektit, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, lidhur me dhënien e gradave policore, e përkatësisht: për njohjen e gradës “Drejtues” paditësit A. Gj. dhe njohjen e gradës “Drejtues i parë” paditësit S. R. Trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë këto dy çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit. Në arsyetimin e saj, shumica vëren se, meqenëse Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i është drejtuar njëkohësisht edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky informacion duhet të trajtohet sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.
11. Ne, gjyqtaret në pakicë, çojmë se çështjet që u administruan në seancëgjyqësore publike nga Kolegji, duhet të ishin marrë në konsideratë në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit. Parë në zbatim të argumentimit të nevojshëm ligjor, cilësisë së analizës, njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor etj., të lidhura me dhënien e gradës policore gjyqësisht, si rezultat i plotësimit të kriterit të vjetërsisë në gradë pretenduar, për personat në fjalëgjykuar nga subjekti i rivlerësimit, rezultojnë se subjekti ka marrë vendime në tejkallim të tagrave të gjykatës. Qëndrimi i shumicës, sipas të cilit informacioni u kanalizua në drejtim të kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pa një vendimmarrje orientim apo vendimmarrje konkrete, pa pasqyruar konstatime të vetë Kolegjit, në vlerësimin tonë është i pabazuar, pasi përbën evitim të përgjegjësive që rrjedhin nga neni 54 i ligjit nr. 84/2016. Kolegji do të duhet të ishte shprehur minimalisht për orientimin e kësaj gjetjeje në funksion të vlerësimit periodik të subjektit nga institucioni përkatës [Këshilli i Lartë Gjyqësor].
12. Nisur nga arsyetimi i përdorur nga shumica e trupit gjykues, që këto dy çështje duhet të trajtohen sipas ligjit të magjistratit nga KLGj-ja, çojmë se është arsyetim i gabuar dhe i pabazuar pasi, referuar procedurës për vlerësimin e aftësive profesionale, parashikuar nga ligji nr. 84/2016, përkatësisht neni 43, pika 4⁶², shumica duhet të kishte vazhduar me vlerësimin e aftësive profesionale, duke trajtuar të paktën çështjen e dytë [që lidhet me paditësin S. R.] në drejtim të një sërë aftësish të subjektit të rivlerësimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar ligjin, parimet e përgjithshme të së drejtës, faktit që vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka disponuar dhënien e përfitimeve [gradës, pagesës etj.] mbi objektin e një konflikti gjyqësor të zgjidhur më parë nga juridiksioni gjyqësor me një vendim të formës së prerë apo dhe ka vënë në ekzekutim të menjëhershëm vendimin për një shumë të konsiderueshme monetare përtej kërtimeve të palës paditëse.
13. Për gjithë sa trajtuam më sipër, çojmë se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit objekt shqyrtimi nuk duhet të ishte lënë në fuqi. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm të kontrollit të pasurisë, pasi kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat, shpenzimet e kryera për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016. Po ashtu, në çështjet që u administruan në Kolegji për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, kishte elemente për t’u marrë në konsideratë në vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në drejtim të tejkallimit të tagrave që ligji u njeh gjyqtarëve në

⁶²Kjo dispozitë parashikon: “[...] Nëse relatori vihet në dijeni nga shtetasit/publiku ose burime të tjera në përputhje me nenin 49 të këtij ligji, mbi fakte të besueshme për punën e subjektit të rivlerësimit, ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale [...]”.

zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e gradave dhe në shkelje të parimeve të përgjithshme të së drejtës. Shumica e trupit gjykues ka gabuar kur ka vendosur lidhur me parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, për lënien në fuqi të vendimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi